



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:197718

Datë: 06.05.2021

Numri i dokumentit: 01791981

C.nr.1024//19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen juridike të paditësit Rr.M nga fshati "...", Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson Nazmije Ibrahimimi avokate nga Ferizaj, kundër të paditurës Ndërmarrja Private "...” me seli në Ferizaj, me pronar B.Sh nga fshati "...”, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Shabani avokat nga Ferizaj, për shkak të kompensimit të dëmit material, në seancën e mbajtur me datë 02.03.2021, merr, ndërsa me datën 29.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit Rr.M nga fshati "...”, Komuna Ferizaj.

II. DETYROHET e paditura Ndërmarrja "...” me seli në Ferizaj, me pronar B.Sh nga fshati "...”, që paditësit Rr.M, në emër të dëmit të pësuar në parcelën nr. "...”Z.K. "...”, të shkaktuar nga heqja e dheut dhe nxjerrja e zhavorrit prej periudhës kohore 20.01.2017 deri më 30.05.2017, në sipërfaqe prej 3266 m² apo 6232 m³, t’ia paguaj shumën prej **14,022.00 €** (katërbëdhjetë mijë e njëzetë e dy euro) me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 3,343.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me forcë.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumë prej **14,333.60 €** (katërbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre euro e gjashtëdhjetë cent) e kërkuar nga paditësi, në emër të nxjerrjes dhe eksplotimit të zhavorrit nga ana e të paditurës, në sasi prej 6232 m³, si e pabazuar.

IV. DETYROHET paditësi që të paguaj taksën gjyqësore shtesë në shumë prej 40.00 €, menjëherë pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditësi më dt.21.08.2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material, kundër të paditurës Ndërmarrja Private "...” me seli në Ferizaj, me pronar B.Sh nga fshati "...”, Komuna Ferizaj.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e paditura pa pëlqimin paraprak të paditësit nga paluajtshmëria e tij ka marrë një sasi të madhe të zhavorrit për nevojat e ndërmarrjes së tij, duke grupuar në këto ngastra në një sipërfaqe të madhe dhe thellësi disa metra, duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm paditësit, ngase ngastrat në fjalë pas nxjerrjes së zhavorrit, nuk i ka kthyer në gjendje të mëparshme, por gropat i ka lënë të hapura, duke i pamundësuar paditësit shfrytëzimin e atyre ngastrave. Paditësi pasi që ka mësuar se në paluajtshmërinë e tij e paditura ka bërë gropimin dhe eksplotimin e zhavorrit, e ka njoftuar policinë për këtë rast, me ç ‘rast përfaqësuesi i të paditurës B.Sh, është zotuar se patundshmërinë e paditësit do ta kthej në gjendjen e mëparshme, për të cilin zotim palët kishin lidhur marrëveshje me shkrim me dt.20.01.2017 sipas së cilës e paditura ka marrë obligim që të bëjë pastrimin dhe rrafshimin e sipërfaqes së tokës së dëmtuar. Edhe pse sipas marrëveshjes në fjalë, e paditura kishte marrë obligim që të sanonte dëmin deri në fund të muajit Maj 2017, e paditura deri më tani nuk e ka përmbushur këtë marrëveshje. Andaj, nisur nga arsyet e lartë përmendura, i autorizuari i paditësit deklaron se ekziston detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit material të shkaktuar në paluajtshmërinë e tij, konform ekspertizës gjyqësore të plotësuar më dt.27.11.2020, ku ka kërkuar shumën prej 14,333.60 € në emër të eksplotimit të zhavorrit si dhe shumën prej 14,022.00 € në emër të rrafshimit të sipërfaqes së dëmtuar, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për faktin se e paditura i ka ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për nivelizimin e asaj pjese të paluajtshmërisë, ashtu siç është paraparë me marrëveshjen të lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse, por në aktivitetin e ndërmarrë për sanimin e dëmit, paditësi e ka penguar të paditurën, duke u sillur në mënyrë arrogante e duke kërkuar që urgjentisht të largohet

makineria nga ai vend. Në vazhdim e paditura deklaroi se gropa në parcelën e paditësit ka ekzistuar edhe më herët, sepse ajo paluajtshmëri ishte pronë publike dhe shumë kompani kishin nxjerrur zhavorr nga vendi i njejtë që nga viti 2000 e në vazhdim, fakt që mund të shihet edhe nga ortofotot e ndryshme nga viti 2000 deri në vitin 2017. Më tej i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se e kundërshton ekspertizën e ekspertit vlerësues në aspekt të lartësisë së çmimit të zhavorrit ngase çmimi i zhavorrit në tërë territorin e Kosovës ë, shtë caktuar në shumë prej 0.50 € për m³ me vendim të Kuvendit të Kosovës nr.04-V-380 të dt.25.05.2018 ndërsa çmimi i caktuar nga eksperti vlerësues në shumë prej 2.30 € është shumë më i lartë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, gjykata ka shqyrtuar provat si vijojnë: *marrëveshjen e lidhur më dt.20.01.2017 në mes palëve Rr.M dhe B.Sh si pronar i Ndërmarrjes "...marrëveshjen e shkruar me shkrim dore ndërmjet të paditurit B.Sh dhe paditësit Rr.M; ekspertizën gjeodezike të hartuar nga gjeodet M.L e dt.31.10.2019; certifikatën e pronësisë për parcelën nr. "... Z.K. "...; ekspertizën financiare të ekspertit I.T e dt.24.01.2020; raportin e vlerësimit plotësues të ekspertit I.T i dt.30.06.2020; raportin plotësues të ekspertit financiar I.T i dt.27.11.2020; plotësim ekspertizën gjeodezike të gjeodetit M.L i dt.19.02.2021; ortofotot e viteve 2001, 2004, 2009, 2012 dhe 2018.*

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi Rr.M në cilësi të palës ka deklaruar se pronën lëndore e ka blerë nga Sh.L nga "...", me sipërfaqe prej 30 hektarë, të cilën kur e kishte blerë nuk ka qenë e dëmtuar as nuk ka pasur të gërmuar as dhe e as zhavorr. Pasi që paditësi kishte marrë vesh se e paditura ia ka dëmtuar pronën i njëjti e kishte paraqitur rastin në polici dhe pas pesë ditësh e kishte takuar pronarin e kompanisë B.Sh me të cilin e kanë lidhur marrëveshjen për sanimin e dëmit, ku pastaj paditësi e kishte tërhequr deklaratën nga policia, duke konsideruar se ka arritur marrëveshje me të paditurën për eliminimin e dëmit, por pas disa ditësh ka vërejtur se e paditura ishte duke marrë dhe nga parcela e paditësit duke e shtyrë për ta mbuluar gropën dhe pasi e kishte parë paditësi se e paditura nuk ishte duke e respektuar marrëveshjen për pastrimin dhe rrafshimin e tokës, paditësi kishte kërkuar nga e paditura që të ndalë punimet.

I padituri B.Sh në cilësi të palës ka deklaruar se ishte takuar me paditësin lidhur me çështjen nxjerrjes së zhavorrit për shtrimin e rrugëve publike dhe paditësi i kishte thënë të paditurit se ekziston një gropë në parcelën e tij ku më parë kishte grupuar personi me emrin Q.h edhe vet paditësi kishte nxjerrë gurë nga e njëjta gropë që nga viti 1972. Fillimisht ishte dakorduar me paditësin që të nxjerrte zhavorr sa të dojë nga parcela e tij dhe të shtronte rrugën por pastaj e kishte kërcënuar që ta ndalonte punën. Pastaj e paditura e kishte ndaluar punën dhe ishte marrë vesh me paditësin që ta sanonin dëmin duke e rrafshuar gropën dhe duke e pastruar parcelën nga shkurret dhe gjësendet tjera, por pasi që e paditura kishte filluar punimet, paditësi kishte shkuar tek parcela dhe kishte kërkuar ndaljen e punimeve.

Eksperti gjeodet M.L, në ekspertizën me shkrim të dt.31.10.2019 ka theksuar se pas matjeve në terren ka gjetur se në parcelën nr. "...” është gërmuar dheu në sipërfaqe prej 3266 m² dhe vëllimi i cili është gërmuar është 6232 m³. Eksperti ka sqaruar se sipas ortofotove të viteve 2001, 2004, 2009, 2012 dhe 2018 shihet se gropa në parcelën e paditësit ka ekzistuar qysh nga viti 2001 por nuk dihet saktë përmasat e asaj grope. Më tej eksperti deklaroi se llogaritjet e tij rreth sasisë së dheut janë llogaritur nga viti 2012 deri në vitin 2019 bazuar në aeroinçizimet.

Eksperti financiar I.T në ekspertizën me shkrim të dt.24.01.2020 si dhe plotësim ekspertizën me shkrim të dt.27.11.2020 ka theksuar se dëmi që i është shkaktuar paditësit nga e paditura me rastin e nxjerrjes së zhavorrit nga parcela nr. "...”, Z.K. "...”, është në vlerë prej 14,022.00 €. Po ashtu, eksperti gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka sqaruar ekspertizën e tij, duke shtuar se lartësia e dëmit në shumë prej 14,022.00 € përfshin furnizimin, bartjen dhe rrafshimin e sipërfaqes tokësore prej 6232 m³ zhavor, ku është llogaritur vetëm vëllimi i dheut, pa llogaritur blerjen e tij. Ndërsa në plotësim-ekspertizën e dt.27.11.2020 eksperti ka deklaruar se çmimi mesatar i shitjes së zhavorrit është 2.30 € për m³ apo në shumë të përgjithshme prej 14,333.60 €.

Gjykata, nga gjendja faktike e vërtetuar, ka ardhur në përfundim se e paditura edhe pse ka pasur marrëveshje me paditësin, me pronarit juridik por nuk ju ka përmbajtur marrëveshjes dhe ka grupuar dhe ka nxjerrë zhavor, gurë dhe materiale tjera inerte gjatë periudhës janar 2017 deri në maj 2017 sipas nga parcela e pronarit në sasi prej 6232 m³, duke e dëmtuar pronën në fjalë në sipërfaqe prej 3266 m² dhe duke i'a pamundësuar paditësit shfrytëzimin e pronës së tij, me ç'rast paditësit i ka shkaktuar dëm material. Ku nga marrëveshja e dt.20.01.2017 e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse janë pajtuar që e

paditura të nxjerr zhavorr nga parcela e paditësit për nevoja të shtrimit të rrugëve publike, ndërsa si kompensim të ndërmerr punime në rrafshimin e gropës në formë të pjerrët si dhe pastrimin e parcelës nga shkurret dhe mbeturinat tjera, në ngastrën nr. ‘...’ZK. ‘...’, për çka nuk ka arritur ta përmbush marrëveshjen e nënshkruar mes tyre.

Andaj, meqenëse e paditura është shkaktare e dëmit material, e njëjta e ka për obligim që ta eliminoj këtë dëm përmes shpërblimit në të holla, në lartësinë të cilën gjykata e ka caktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimit, ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit vlerësues I.T, të cilës i’a ka falur besimin pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket vlerësimit të dëmit të pësuar në parcelën nr. ‘...’nga heqja e dheut dhe nxjerrja e zhavorrit të cilin dëm eksperti e ka vlerësuar në shumë prej 14,022.00 €. Sa i përket vlerësimit lidhur me eksploatimin e sasisë së zhavorrit në shumë prej 14,333.60 €, për këtë pjesë gjykata nuk i’a ka falur besimin ekspertizës, sepse qëllimi fillestar i palëve ndërgjyqëse në marrëveshjen e dt.20.01.2017 deri me 30.05.2017, ishte që i padituri të merrte zhavorrin nga parcela e paditësit dhe si kompensim t’ia rregullonte sipërfaqen e parcelës nr. ‘...’ZK ‘...’, duke e rrafshuar gropën me një pjerrtësi dhe pastrimin e parcelës nga shkurret dhe mbeturinat tjera.

Prandaj, gjykata si shumë të arsyeshme për kompensimin e dëmit e ka caktuar lartësinë prej 14,022.00 €, si shumë reale, e cila përkon me vëllimin e dëmit të shkaktuar dhe e cila shumë konsiderohet si shumë e mjaftueshme që t’ia mundësojë paditësit sanimin e plotë të dëmit material, duke i’a mundësuar kthimin e pronës lëndore në gjendjen e mëparshme, në formën dhe destinimin e saj të cilin e kishte para se të shkaktohej dëmi.

Për gjykatën, si fakt vendimtar dhe i pamohueshëm në këtë çështje juridike kontestimore është fakti i ekzistimit të dëmit material, të cilin e ka pësuar pronari i ngastrës kadastrale lëndore me veprimet e drejtpërdrejta të palës së paditur. Sipas nenit 169 të LMD-së parashihet që: ***“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi....Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon...”*** andaj me që u konstatua se e paditura është shkaktare dhe përgjegjëse për dëmin e pësuar, atëherë e njëjta ka për obligim që të bëjë kompensimin e dëmit në lartësinë e përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të ekspertit.

Gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë prej 14,333.60 € e kërkuar nga paditësi, në emër të nxjerrjes dhe eksploatimit të zhavorrit nga ana e të paditurës, në sasi prej 6232 m³, si e pabazuar, për faktin se, me aprovimin e kërkesëpadisë si në pikën dy të dispozitivit, paditësit i është njohur dëmi në atë vlerë deri sa me këtë pjesë të kërkesës së paditësit, realizimi i së cilës kërkohet i bie që i njëjti të kompensohet dy herë, deri sa në emër të dëmit të njohur paditësit në shumën prej 14.022.00€, eksperti ka vlerësuar se për metër kube, i bie 2.30€ dhe jo siç ka kërkuar paditësi kompensimin e dheut-gurëve plus kompensimin e vlerës për kthim në gjendje të mëparshme apo dyfishim i kërkesës, e që është në kundërshtime me dispozitën e nenit 169.3 të LMD-së andaj edhe është refuzuar kjo pjesë e kërkesëpadisë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat dhe thëniet tjera të palëve në këtë shqyrtim, mirëpo ka vlerësuar se të njëjtat janë pa ndikim në marrjen e këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 143 të LPK-së, lidhur me nenin 136 par.1, 140, 169 par.3, 170 dhe 382 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 452 par.1 dhe par.2 të LPK-së me të cilën e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 3,343.00 € dhe atë si në vijim: për taksën gjyqësore shumën prej 100.00 €, për ekspertizën geodezike shumën prej 100.00 € dhe për raportin vlerësues shumën prej 100.00 €, për përpilimin e padisë nga avokati, shumën prej 208.00 €, për nëntë seanca të mbajtura nga 270.00 € dhe tri seanca të shtyra nga 135.00 €, apo të gjitha së bashku në shumë prej 2,835.00 € konform tarifës së OAK-së.

Paditësi është obliguar të bëjë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumë prej 40.00 €, konform nenit 12.1 të UA nr.1/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1024/19, me datën 29.04.2021

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.